



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1237/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit R... me seli ne Prishtinë, kundër debitorit B. I D.P.T “E...” me seli ne Vushtrri, me pronar E.G nga Vushtria, duke vendosu sipas ankesës së ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega ne Vushtrri CPP.nr.428/21, të datës 09.02.2022, me datë 26.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Biznes Individual D.P.T “E...” me seli ne Vushtrri, me pronar E.G, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë -Dega ne Vushtrri CPP.nr.428/21, të datës 09.02.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega ne Vushtrri, me aktvendimin CPP.nr.428/21, të datës 09.02.2022, e ka refuzuar prapësimin e debitorit Biznes Individual D.P.T “E...” me seli ne Vushtrri, me pronar E.G, te ushtruar kundër Urdhrit për përmbarim P.nr.330/21 te datës 12.10.2021, te lejuar nga Përmbaruesja private Saranda Rexhepi me seli ne Prishtinë, ndërsa dhe urdhërin përmbarimor e ka lënë ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori përmes përfaqësuesit E.G, për shkak shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës kontestimore dhe vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë te bazuar, aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej ne rivendosje.

Përgjigje ne ankesë ka paraqitur kreditori, me arsyetimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori, për arsye se prapësimi duhet te mbështet ne prova te duhura konform nenit 69 par.4 e po ashtu kërkohet qe prapësimi te paraqitet konform nenit 71 te LPP, me propozim qe te refuzohet ankesa si e pabazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar te vërtetohet.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori R... nga Prishtina, me datën 08.10.2021, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit Biznes Individual D.P.T “E...”, ndërsa përbaruesja private Saranda Rexhepi ka lejuar përbarimin me urdhrin për përbarim P.nr.330/21 dt.12.10.2021, në bazë të dokumentit përbarues-Marrëveshjes për kredinë nr. te datës 16.05.2021 ne shumen prej 7.000 euro, shtojcën nr.2 te marrëveshjes nr.200724461 ne kredi te re nr. te datës 28.01.2020 ne shumen prej 6 950 euro, marrëveshjes për lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa kredit kartelës me date 16.05.2021 ne shumen prej 3 000 euro, shtojcës nr.2 te për shndërrimin e Visa kredit kartelës me kredi te re nr. ne shumen prej 3.150 euro, konfirmimit te rexhistrimit te pengut R-20200117-388 te lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit te Bizneseve ne Kosovë-Regjistri i pengut, ne total shumen prej 10,503.01 euro si dhe kamatën e rregullt dhe kamatëvonesa deri ne pagesën definitive.

Kundër këtij urdhri debitori me përfaqësues E.G me datë 01.11.2021, kanë paraqitur prapësim, duke pretenduar se Propozimi për përbarim dhe urdhri përbarimor janë ne kundërshtim me nenin 22 dhe 29 te LPP, duke parashtruar se dokumenti ne bazë te cilit është marrë vendimi përbarues nuk ka titull ekzekutiv, si dhe nuk ka tipare te përbarueshmërisë, me propozim qe gjykata e shkalles e parë ta aprovoj prapësimin si te bazuar, ndërsa urdhrin për përbarim ta anuloj.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori R..., me pretendimin se arsyet e paraqitura te debitorit ne prapësim nuk qëndrojnë dhe se kundërshton prapësimin ne tërësi si te pabazuar, sa i përket titullit ekzekutiv, arsyeton se si dokument i përbarueshëm për marrëveshjen e kredisë dhe marrëveshjen e pengut është certifikata për Regjistrimin e Pengut e cila lëshohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Agjencioni për regjistrim te bizneseve ne Kosovë - Zyra për regjistrim te pengut, e cila lëshohet ne mënyrë elektronike dhe si e tillë përdoret pranë organeve gjyqësore, duke theksuar se debitorët kanë tendenca te prolongimit te procedurës përbarimore dhe se te njëjtit nuk e kanë bazuar prapësimin ne nenin 71 te LPP, andaj i propozon gjykatës qe prapësimi te refuzohet ne tërësi si e pabazuar dhe urdhri për lejimin e përbarimit te mbetet ne fuqi.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega ne Vushtrri, pas vlerësimit të prapësimi, përgjigjes në prapësim dhe shkresave ne lëndë, ka nxjerrë aktvendimin CPP.nr.428/21, të datës 09.02.2022, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit duke vendosur

si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka arsyetuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar sepse me marrëveshjen mbi Kreditinë, marrëveshjen mbi Pengun për sigurim të kredisë, aneks kontrata për kreditinë dhe marrëveshjen për lëshimin e Visa Biznes Kredit Kartelës të datës 28.01.2020 debitori ka përfituar kreditinë në shumat totale dhe nga kjo shumë ka filluar pagesat sipas marrëveshjes por ndërkohe i njëjti ka stopuar përmbushjen e kredisë duke mbetur në detyrim ndaj kreditorit në shumën si në propozim prej 10,503.01 euro, të cilin detyrim ka qenë dashur ta përmbushte konform nenit 8 dhe 245 par.1 të LMD. Me tej ka saruar se kontrata për pengun sipas nenit 22 par.1 nënpar.1.7 të LPP lidhur me nenin 5 par.2 pika 1.7 (a) të Ligjit për plotësim e ndryshim të Ligjit për Procedurën Përmbartimore 02/L-118 është dokument përmbartimor mbi bazën e të cilit lejohet dhe zbatohet përmbartimi, andaj asnjë nga shkaqet e pretenduara në prapësim nuk u vërtetuan në rastin konkret.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbartimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbartimin sipas dokumentit të përmbartimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, dhe në prapësimin e debitorëve nuk janë paraqitur asnjë nga shkaqet të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së, që do të pengonin përmbartimin e lejuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i debitorit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se në rastin konkret përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin duke u bazuar në marrëveshjet e arritura në mes debitorit dhe kreditorit, si marrëveshjen mbi kreditinë nr. të muajit Janar 2020, marrëveshjen mbi pengun, shtojca nr. 1, marrëveshjen mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes Kredit Kartelës e datës 28.01.2020, shtojca nr.2 dhe aneks kontrata e datës 28.01.2020, lëshuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë –Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve – Regjistri i Pengut për sigurimin e kredisë, e kjo vërtetohet në bazë të konfirmimit të regjistrimit të pengut R-20200117-3887 e datës 18.05.2021, pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Zyrën për Regjistrimin e Pengut, dhe të njëjtat paraqesin dokumente përmbartuese në kuptim të dispozitës së nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, shprehimisht

përcaktohet se: *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut*”, e që në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbarimit dhe në të njëjtën kohë edhe për refuzimin e prapësimit të debitorit, andaj edhe në këtë drejtim këto pretendime të debitorit kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi ti refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Dhoma e shkallës së dytë i ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit por të cilat nuk kanë qenë me rëndësi vendimtare për të vendosur ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë dhe se për këtë arsye gjykata ankimore ka vendosur që ti refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,
DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.1237/22, me datë 26.09.2022**

Gjyqtari
Faton Bajrami